



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.102

1 korrik

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9895, datë 9.6.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar..... 4475
Ligj nr.9925 datë 9.6.2008	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane “Për trajtimin doganor të paletave të përdorura në transportin ndërkombëtar”..... 4482
Ligj nr.9926 datë 9.6.2008	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për taksimin e automjeteve rrugore për përdorim privat në trafikun ndërkombëtar” dhe në protokollin e nënshkrimit..... 4488
Ligj nr.9927 datë 9.6.2008	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 28.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për dërgimin në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore, si kontribut i Republikës së Shqipërisë, të një kompanie të Forcave të Armatosura, për të marrë pjesë në operacionin “EUFOR TCHAD/RCA” të Bashkimit Europian”..... 4493
Ligj nr.9928 datë 9.6.2008	Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë 4494
Ligj nr.9929 datë 9.6.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar..... 4497
Ligj nr.9930 datë 9.6.2008	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”..... 4499
Ligj nr.9931 datë 9.6.2008	Për disa ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar..... 4503

Ligj nr.9932 datë 9.6.2008	Për disa ndryshime në ligjin nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	4504
-------------------------------	--	------

Vendim i Kuvendit nr.192, datë 30.6.2008	Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Kodin Zgjedhor	4505
---	---	------

LIGJ
Nr.9895, datë 9.6.2008

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9482, DATË 3.4.2006 “PËR
LEGALIZIMIN, URBANIZIMIN DHE INTEGRIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime e shtesa:

Neni 1

Në nenin 1 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Legalizimin e ndërtimeve informale dhe të objekteve me leje, me shtesa informale në objekt”.

2. Në pikën 4, fjalët “zonave/ndërtimeve informale” zëvendësohen me fjalët “ndërtimeve informale/objekteve me leje, me shtesa informale në objekt”.

Neni 2

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 shfuqizohet.

2. Pas pikës 4 shtohen pikat 4/1 dhe 4/2 si më poshtë:

“4/1. Fusha e zbatimit të këtij ligji nuk shtrihet për ndërtimet informale mbi 3 kate, të ngritura në troje private, brenda vijës së verdhë, kur ato nuk janë shtesa informale në objekt, sipas përcaktimit të bërë në nenin 1 të këtij ligji.

4/2. Fusha e zbatimit të këtij ligji nuk shtrihet për ndërtimet informale brenda një distance prej 100 metrash nga akset rrugore kombëtare, me përjashtim të rasteve kur ndërtimi informal përfshihet brenda një zone informale të miratuar.”.

3. Në pikën 5, fjalët “sipas ligjit nr. 8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”” zëvendësohen me fjalët “sipas ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit””.

Neni 3

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “a”, fjalët “brenda territorit të përcaktuar si “vendbanim formal”, “zonë informale” ose “territore të tjera”” shfuqizohen.

2. Shkronja “b” riformulohet si më poshtë:

“b) “Zonë me ndërtime të legalizuara” është territori me sipërfaqe mbi 5 ha, i zënë nga ndërtime të legalizuara, që nuk gëzon mbrojtje të veçantë nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi.”.

3. Shkronja “c” riformulohet si më poshtë:

“c) “vendbanim me ndërtime të legalizuara” është territori me sipërfaqe mbi 5 ha, i miratuar zyrtarisht për zonë të banuar urbane (qytet) ose rurale (fshat), i zënë nga ndërtime të legalizuara.”.

4. Shkronja “ç” riformulohet si më poshtë:

“ç) “bllokbanim me ndërtime të legalizuara” është territori me sipërfaqe mbi 1 ha deri në 5 ha,

brenda ose jashtë vendbanimit formal, i zënë me ndërtime të legalizuara.”.

5. Shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:

“d) “kufiri i zonës/vendbanimit/bllokbanimit me ndërtime të legalizuara” është vija gjeografike e shtrirjes territoriale të ndërtimeve të legalizuara, për të cilin do të miratohet studimi urbanistik, sipas dispozitave në fuqi, nga KRRTRSH-ja dhe/ose KRRT-të përkatëse.”.

6. Shkronja “e” shfuqizohet.

7. Pas shkronjës “gj” shtohet shkronja “gj/1” me këtë përmbajtje:

“gj/1) “kartela e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme të legalizuar” është dokumenti, që hartohet nga ALUIZNI, për regjistrimin fillestar të pasurisë së paluajtshme të legalizuar.”.

8. Në shkronjën “i”, fjalët “bashkërendon punën nëpërmjet organeve qendrore shtetërore dhe njësive të qeverisjes vendore/njësive bashkiake” shfuqizohen.

Neni 4

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale

1. Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) është institucioni përgjegjës për:

a) realizimin e procesit të legalizimit dhe përgatitjen për regjistrim fillestar të ndërtimeve informale, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë ligj;

b) bashkëpunimin dhe njësimin e procedurave me organet qendrore shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për procesin e legalizimit, urbanizimit dhe integritit të zonave/vendbanimeve/bllokbanimeve me ndërtime të legalizuara;

c) programimin e fondeve nga Buxheti i Shtetit për legalizimin dhe urbanizimin e territoreve informale;

ç) krijimin dhe përpunimin e informacionit hartografik, në shkallë 1:500 - 1:5000, që do të përdoret për procesin e legalizimit dhe të urbanizimit të ndërtimeve informale, si dhe për investime në infrastrukturë, në nivel kombëtar;

d) dhënien e lejes së legalizimit, sipas nenit 28 të këtij ligji.

2. ALUIZNI, në zbatim të detyrave të vendosura nga ky ligj, kryen:

a) fushatën kombëtare të informimit dhe të sensibilizimit të qytetarëve, në bashkëpunim me mjetet e informimit të gjerë publik, në nivel kombëtar;

b) verifikimin dhe përditësimin në terren të ndërtimeve informale, si dhe pasqyrimin e tyre në hartën e përfutur nga fotografimi ajror;

c) ngritjen e bazës së të dhënave për ndërtimet pa leje dhe ecurinë e legalizimit;

ç) përgatitjen e manualeve të procedurave, udhëzimeve dhe formularëve.

3. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të kësaj agjencie, të drejtorisë qendrore, drejtorive në nivel qarku dhe zyrave pranë njësive të veçanta të qeverisjes vendore përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 5

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

Në shkronjën “b”, fjalët “sipas ligjit nr. 8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”” zëvendësohen me fjalët “sipas ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit””.

2. Shkronja “c” shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 6, shkronjat “a” e “b” shfuqizohen.

Neni 7

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Procedura e legalizimit të ndërtimeve pa leje

Për legalizimin e ndërtimeve informale ndiqen procedurat e mëposhtme:

a) njësia e qeverisjes vendore, ku janë ngritur ndërtimet informale të vetëdeklaruar, kryen kualifikimin e tyre dhe dërgon pranë drejtorisë rajonale të ALUIZNI-t, brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, dokumentacionin e mbledhur gjatë fazës së vetëdeklarimit dhe argumentimin tekniko-ligjor të kualifikimit.

Kur njësia e qeverisjes vendore nuk ushtron përgjegjësinë për kualifikimin e objekteve informale, brenda afatit, kjo përgjegjësi ushtrohet nga ALUIZNI;

b) drejtoria rajonale e ALUIZNI-t bën përpunimin e të dhënave të ndërtimeve pa leje, në përputhje me situatën e paraqitur nga fotografimi ajror dixhital, sipas ndarjes kadastrale;

c) për ndërtimet informale, që nuk përjashtohen nga legalizimi, sipas nenit 39 të këtij ligji, ALUIZNI plotëson dokumentacionin tekniko-ligjor;

ç) përgjatë procedurës së hartimit dhe plotësimit të dokumentacionit, ALUIZNI, në bashkëpunim me ZRPP-në, identifikon rastet kur parcela ndërtimore, në të cilën është ngritur objekti informal, figuron e regjistruar në regjistrat e pronave të paluajtshme në pronësi të të tretëve;

d) ALUIZNI i dërgon Këshillit të Ministrave, për vendimmarrje, materialin me të dhënat për çdo pronar të ligjshëm dhe për sipërfaqet takuese, jo më vonë se 30 ditë nga data e dërgimit të listës paraardhëse. Afati i parë për dërgimin e kësaj liste është data 1 gusht 2008;

dh) pas plotësimit të dokumentacionit, ALUIZNI miraton legalizimin e ndërtimit informal dhe lëshon lejen e legalizimit.”.

Neni 8

Neni 11 shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 13 bëhet ky ndryshim:

Në pikën 3, fjalët “Policinë e Ndërtimit” zëvendësohen me fjalët “inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut”.

Neni 10

Neni 14 shfuqizohet.

Neni 11

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

Regjistrimi i pasurisë në ZRPP

Për ndërtimet e legalizuara, ALUIZNI përgatit dokumentacionin për regjistrim në regjistrat e pronave të paluajtshme pranë ZRPP-së, në përputhje me ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” të ndryshuar”.

Neni 12

Pas nenit 15 shtohet neni 15/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 15/1

Kompensimi i ish-pronarëve

1. Për rastet e parashikuara në shkronjën “d” të nenit 10, Këshilli i Ministrave merr vendim për shpërblimin e pronarëve dhe për sipërfaqet takuese, brenda 30 ditëve nga afati i dorëzimit të listës.

2. Zyrat rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave kompensojnë subjektet brenda 3 muajve, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave për shpërblimin e pronarëve.

3. Për efekt të përllogaritjes së sipërfaqes së parcelës ndërtimore, të zënë nga ndërtimi informal, që kompensohet, agjencia e kthimit dhe kompensimit të pronave në qark e trajton atë si truall, në përputhje me metodikën për vlerësimin e pronës së paluajtshme, që kompensohet dhe asaj që do të shërbejë për kompensim, sipas ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.”.

Neni 13

Në nenin 16 pika 1, fjalët “në zyrën e urbanistikës” zëvendësohen me fjalët “në drejtorinë rajonale të ALUIZNI-t”.

Neni 14

Në nenin 17 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Përpara pikës 1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“ALUIZNI, me vendim të Këshillit të Ministrave, ngarkohet të kryejë procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.”.

2. Në pikën 1 fjalët “nga shteti te vetëdeklaruesi” shfuqizohen.

3. Në nenin 17, pika 3 riformulohet si më poshtë:

“3. ALUIZNI përcakton destinacionin e objektit, sipas verifikimit në terren.”.

Neni 15

Në nenin 23, fjalët “sipas pikës 2 të nenit 16 të ligjit nr. 8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, zëvendësohen me fjalët “sipas pikës 2 të nenit 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”.

Neni 16

Në nenin 27 bëhen këto ndryshime:

1. Fjalja e parë ndryshohet si më poshtë:

“Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e ndërtimit informal përfshin:”.

2. Në shkronjën “a”, fjalët “të lëshuar nga njësia e qeverisjes vendore” zëvendësohen me fjalët “të përgatitur nga ALUIZNI”.

3. Në fund të shkronjës “d” shtohen fjalët “dhe/ose çdo akt tjetër ligjor për fitimin e pronësisë.”.

4. Në shkronjën “dh”, fjalët “cilësive të punimeve të objektit” zëvendësohen me fjalët “faktorëve, që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit”.

5. Në fjalinë e fundit, fjalët “pranë njësisë së qeverisjes vendore, ku ndodhet objekti pa leje” shfuqizohen.

Neni 17

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 28
Dhënia e lejes së legalizimit

ALUIZNI, me plotësimin e të gjithë dokumentacionit të përcaktuar në nenin 27 të këtij ligji, pajis subjektin me lejen e legalizimit. I njëjti rregull zbatohet edhe për objektet me leje, me shtesa informale në objekt, ku leja e legalizimit është e barasvlefshme me lejen e shfrytëzimit, të përcaktuar sipas ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. Kriteret dhe procedurat e legalizimit të ndërtimeve informale/objekteve me leje, me shtesa informale në objekt, si dhe formulari i lejes së legalizimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 18

Neni 29 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 29
Dokumentacioni për regjistrimin e objektit në ZRPP

Leja e legalizimit, e shoqëruar nga dokumentacioni teknik dhe kartela e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme të legalizuar paraqiten nga ALUIZNI në ZRPP për regjistrimin fillestar të objektit në regjistrat e pasurive të paluajtshme, në përputhje me ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.”.

Neni 19

Neni 31 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 31
**Urbanizimi i zonave/vendbanimeve/bllokbanimeve
me ndërtime të legalizuara**

1. Urbanizimi i zonave/vendbanimeve/bllokbanimeve me ndërtime të legalizuara kryhet në bazë të studimeve urbanistike, në përfundim të procesit të legalizimit.

a) Njësia e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me ALUIZNI-n, i propozon KRRT-ve apo KRRTRSH-së, për miratim, kufirin e zonës/vendbanimit/bllokbanimit me ndërtime të legalizuara.

b) Hartimi i studimeve urbanistike realizohet ose porositet nga njësitet e qeverisjes vendore, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Në çdo rast, studimet urbanistike duhet të respektojnë planet e miratuara nga KRRT-ja e bashkisë/komunës, të hapësirave dhe shesheve publike, për investime në rrugë, infrastrukturë dhe objekte social-kulturore.

c) KRRT-ja e këshillit të qarkut miraton studimin urbanistik për bllokbanimet me ndërtime të legalizuara për qarkun respektiv. Bashkia/komuna vepron për të gjitha territoret brenda vijave të verdha.

ç) Miratimi i studimeve urbanistike për zonat/vendbanimet me ndërtime të legalizuara nga KRRTRSH-ja bëhet në mbledhjen e saj më të afërt, pas miratimit të tyre nga njësia e qeverisjes vendore përkatëse dhe pas dorëzimit në KRRTRSH. Për studimet urbanistike të zonave/vendbanimeve/bllokbanimeve me ndërtime të legalizuara, ALUIZNI përgatit oponencën përkatëse teknike.

d) Për zonat/ndërtimet e legalizuara hartohen normat dhe standardet urbanistike minimale.

Ngarkohen ALUIZNI dhe Instituti i Studimeve dhe Projekttimeve Urbanistike për hartimin e këtyre normave/standardeve, brenda 2 muajve nga miratimi i këtij ligji. Normat dhe standardet urbanistike minimale miratohen nga KRRTRSH-ja.

2. Për urbanizimin e zonave informale, gjatë procesit të hartimit të studimeve urbanistike dhe

realizimit të tyre, mund të kontribuojë edhe komuniteti i zonës, sipas një kontrate bashkëfinancimi dhe kontrolli, të nënshkruar për këtë qëllim.”.

Neni 20

Në nenin 32 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime:

a) shkronja “a” riformulohet si më poshtë:

“a) 20 për qind e të ardhurave në buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore për investime vendore, në infrastrukturë e shërbime, për zonën/bllokun me ndërtime të legalizuara dhe për sistemimin me banesë të familjeve të pastreha, sipas nenit 35 të këtij ligji;”.

b) Në shkronjën “b”, fjalët “Komitetin Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” zëvendësohen me fjalët “Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”.

2. Në pikën 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas fjalëve “procesin e vetëdeklarimit dhe të legalizimit” shtohen fjalët “arkëtohen nga ALUIZNI dhe destinohen”.

b) Fjalët “organet, që kryejnë shërbimin” shfuqizohen.

c) Fjalët “dhe financimin e studimeve urbanistike të territorit me ndërtime pa leje” shfuqizohen.

Neni 21

Neni 33 riformulohet si më poshtë:

“Neni 33

Dispozitë detyruese

Mosdeklarimi brenda afatit kohor, si dhe mosparaqitja nga subjekti vetëdeklarues i dokumentacionit të plotë ligjor, sjell përjashtimin nga procesi i legalizimit, urbanizimit dhe integritetit të ndërtimeve informale dhe prishjen e objektit pa leje, në përputhje me ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”.”.

Neni 22

Neni 35 riformulohet si më poshtë:

“Neni 35

Trajtimi i rasteve të veçanta brenda vijës së verdhë për efekt të planit rregullues

Për ndërtimet pa leje, të parashikuara në pikën 4 të nenit 2 të këtij ligji:

1. Familja që disponon ndërtimin pa leje në këtë territor, do të përfshihet në kategorinë e familjeve të pastreha.

2. Statusi i parcelës ndërtimore nuk ndryshon, e drejta e zhvillimit të saj i përket pronarit të ligjshëm dhe objekti pa leje shfrytëzohet nga familja që e disponon atë, deri në momentin e sistemimit me banesë.

3. Procedura dhe mënyra e sistemimit me banesë të familjeve të pastreha, sipas këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut ndërhyr për prishjen e objektit me njoftimin nga ALUIZNI, kur disponuesi i ndërtimit pa leje është sistemuar me banesë.”.

Neni 23

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 36

Legalizimi i objekteve me shtesa

Ky ligj i shtrin efektet edhe për legalizimin e objekteve, me leje ndërtimi nga KRRT-të apo KRRTRSH-ja, tek të cilat janë kryer shtesa anësore apo në lartësi, tej lejes së ndërtimit, si dhe për legalizimin e shtesave, në objektet e ngritura përpara vitit 1993.

Këtu përfshihet edhe legalizimi i objekteve të miratuara me vendim të KRRT-së së njësisë së qeverisjes vendore ose të KRRTRSH-së, të cilat kanë ndryshime në funksionin e hapësirave.”.

Neni 24

Në nenin 37 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Në paragrafin e parë fjalët “gjatë vetëdeklarimit” shfuqizohen.

2. Në fund të nenit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për objektet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit, zyra e urbanistikës së njësisë së qeverisjes vendore përcjell pranë ALUIZNI-t argumentimin tekniko-ligjor të kualifikimit, dokumentacionin e sipërpërmendur, si dhe çdo dokumentacion tjetër që ajo disponon për objektet, në përputhje me afatin e vendosur në nenin 10 shkronja “a” të këtij ligji.”.

Neni 25

Pas nenit 38 shtohet neni 38/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 38/1

**Legalizimi i ndërtimeve pa leje në territoret
me përparësi zhvillimin e turizmit**

Legalizimi i ndërtimeve informale në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit do të kryhet pas përcaktimit të vijës kufizuese të këtyre zonave. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të ligjit.”.

Neni 26

Në nenin 41 bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:

1. Fjalët “njësia e urbanistikës” zëvendësohen me fjalët “ALUIZNI”.

2. Pas fjalës “e paraqitura” shtohen fjalët “pranë njësisë së qeverisjes vendore”.

3. Fjalja e dytë shfuqizohet.

Neni 27

Në nenin 43 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Për rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, kur procesi i vetëdeklarimit është kryer nga blerësit e ndërtimit me shtesë, legalizimi i ndërtimit informal kryhet në favor të këtyre të fundit. Për subjektin/shoqëritë ndërtuese (dhe/ose investitorin) do të ndiqen procedurat për pagesën e penaliteteve.”.

Neni 28

Në nenin 45 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, fjalët “sipas ligjit nr. 8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”” zëvendësohen me fjalët “sipas ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit””.

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Në territoret e përcaktuara si territore me ndërtime informale ndalohet dhënia e lejeve për shesh ndërtimi ose e lejeve të ndërtimit subjekteve private, deri në miratimin e studimit urbanistik për to.”.

Neni 29

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

LIGJ
Nr.9925, datë 9.6.2008

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN EUROPIANE “PËR
TRAJTIMIN DOGANOR TË PALETAVE TË PËRDORURA NË TRANSPORTIN
NDËRKOMBËTAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën europiane “Për trajtimin doganor të paletave të përdorura në transportin ndërkombëtar”, nënshkruar në Gjenevë më 9 dhjetor 1960.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5781, datë 30.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

E/ECE/396
E/ECE/TRANS/519

**KOMISIONI EKONOMIK PËR EVROPËN
KOMITETI I TRANSPORTIT TOKËSOR**

KONVENTA EVROPIANE MBI TRAJTIMIN DOGANOR TË PALETAVE TË PËRDORURA NË
TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR

Bërë në Gjenevë, më 9 dhjetor 1960

KOMBET E BASHKUARA
KONVENTA EVROPIANE MBI TRAJTIMIN DOGANOR TË PALETAVE TË PËRDORURA NË
TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR

Palët Kontraktuese,

duke marrë parasysh rritjen e përdorimit të paletave në transportin ndërkombëtar, që rezulton veçanërisht nga grumbullimi i caktuar i paletave,

duke kërkuar që, si një mjet për të lehtësuar transportin ndërkombëtar e zvogëluar koston e tij, të nxitin këtë rritje,

kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Për qëllime të kësaj Konvente:

a) termi “detyrime të importit dhe taksa të importit” nënkupton jo vetëm detyrimet doganore, por gjithashtu dhe të gjitha detyrimet e taksat e vendosura për efekt të importit;

b) termi “paletë” nënkupton një pajisje mbi të cilën mund të vendoset një sasi mallrash që të formojë një njësi ngarkese për qëllimin e transportimit të saj, ose të përpunimit apo magazinimit të saj me anë të pajisjeve ngritëse mekanike. Kjo pajisje përbëhet nga dy suprina të ndara me elementë të brendshëm mbajtës, ose të një suprine me mbështetëse; lartësia e përgjithshme ulet në minimumin e lejuar të përpunimit me vinça pirun dhe platforma ngritëse të kamionëve; kjo mund të ketë ose jo një strukturë të caktuar;

c) termi “person” nënkupton personat fizikë dhe juridikë.

2. Kjo Konventë do të zbatohet për paletat e importuara në territorin e një Pale Kontraktuese nga territori i një Pale tjetër Kontraktuese.

Neni 2

1. Çdo Palë Kontraktuese do të lejojë pranimin, pa pagesën e detyrimeve dhe taksave të importit, si dhe pa ndalime e kufizime importi, të paletave, me kusht që:

a) të kenë qenë eksportuar më parë, ose që do të rieksporthen më pas, ose

b) që një numër i njëjtë paletash të të njëjtit lloj dhe materialisht të së njëjtës vlerë kanë qenë eksportuar më parë ose do të eksportohen më pas.

2. Sipas dispozitave të nenit 3 të kësaj Konvente, procedura e pranimi të paletave e paraqitur në paragrafin 1 të këtij neni do të përkufizohet nga rregulloret e secilës prej Palëve Kontraktuese. Këto rregullore, në veçanti, mund të përfshijnë dispozita për parandalimin e importit të përhershëm, përjashtuar nga detyrimet dhe taksat e importit të një sasie paletash më të mëdha, sesa ato që eksportohen, ose që do të eksportohen.

3. Çdo Palë Kontraktuese do të përpiqet të kryejë formalitetet sa më thjesht që të jetë e mundur dhe, në veçanti, të mos kërkojë një sigurim në lidhje me detyrimet dhe taksat e importit.

Neni 3

1. Çdo Palë Kontraktuese do të zbatojë dispozitat e nenit 2, paragrafi 1 të kësaj Konvente, pa kërkuar në lidhje me importin dhe eksportin, qoftë paraqitjen e një dokumenti doganor apo sigurimi në lidhje me detyrimet dhe taksat e importit për paletat e grumbulluara në bazë të një marrëveshjeje, sipas të cilës palët do të:

a) shkëmbejnë ndërmjet tyre, nga njëri vend në vendin tjetër, paleta të të njëjtit lloj gjatë veprimeve, të përfshira në transportin ndërkombëtar të mallrave,

b) mbajnë detajet për çdo lloj paletë, duke treguar numrin e paletave të shkëmbyera nga njëri vend në vendin tjetër dhe

c) ndërmarrin dorëzimin tek njëri-tjetri, brenda një periudhe të caktuar, të numrit të paletave të të njëjtit lloj, të nevojshme për të përfshirë në intervale kohe të rregullta, mbi baza dypalëshe dhe shumëpalëshe, prapambetjet e balanceve të deriatëhershme.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni do të jenë të zbatueshme, vetëm nëse:

a) paletat mbajnë shenja në përputhje me marrëveshjen e grumbullimit tashmë të caktuar;

b) marrëveshja e grumbullimit të caktuar iu komunikohet administratave doganore të Palëve Kontraktuese përkatëse dhe këto organe e miratojnë atë, duke rënë dakord që llojet e paletave janë të përcaktuara siç duhet dhe që do të sigurohet zbatimi i duhur e i përshtatshëm i marrëveshjes.

Neni 4

Çdo Palë Kontraktuese rezervon të drejtën të vendosë detyrime dhe taksa të brendshme dhe detyrime e taksa importi, nëse ka, të cilat zbatohen në këtë vend për paletat e blera, ose në varësi të një kontrate të ngjashme të zbatuar nga personat që banojnë ose ndodhen në territorin e tij. Çdo Palë Kontraktuese ruan të drejtën e saj, për më tepër, të refuzojë në varësi të paletave të eksportuara, sipas dispozitave të kësaj Konvente, rimbursimin ose faljen e taksave të paguara në tërësi, ose pjesërisht, si dhe të përfitimeve që mund të ofrohen për arsye të eksportimit.

Neni 5

Kjo Konventë nuk do të ndalojë dhënien, në varësi të importit dhe eksportit të paletave të pajisjeve lehtësuese, më tepër se ato të parashikuara në dispozitat e saj.

KAPITULLI II DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 6

1. Vendet anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën dhe vendet e pranuar në Komision si palë konsultative, sipas paragrafit 8 të termave të referencës së Komisionit, mund të bëhen Palë Kontraktuese e kësaj Konvente:

- a) duke e nënshkruar;
- b) duke ratifikuar atë, pasi kanë nënshkruar duke marrë parasysh ratifikimin;
- c) duke aderuar në të.

2. Vendet që mund të marrin pjesë në aktivitete të caktuara të Komisionit Ekonomik për Europën, në përputhje me paragrafin 11 të termave të referencës së Komisionit, mund të bëhen Palë Kontraktuese e kësaj Konvente duke aderuar në të, pasi ajo të ketë hyrë në fuqi.

3. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim deri dhe përfshirë datën 15 mars 1961. Në vijim, ajo do të jetë e hapur për aderim.

4. Ratifikimi ose aderimi do të hyjnë në fuqi pas depozitimit të një instrumenti pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 7

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë nga data kur pesë vendet e referuara në nenin 6, paragrafi 1, e kanë nënshkruar atë pa rezervën e ratifikimit ose kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose aderimit.

2. Përsa i takon çdo vendi që e ratifikon ose aderon në këtë Konventë, pasi pesë shtete e kanë nënshkruar atë pa rezervën e ratifikimit ose kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose aderimit, kjo Konventë do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë pasi vendi i lartpërmendur të ketë depozituar instrumentin e tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 8

1. Çdo Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Konventë duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi do të hyjë në fuqi pesëmbëdhjetë muaj nga data kur Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara është njoftuar për denoncimin.

Neni 9

Kjo Konventë do të shfuqizohet, nëse, për një periudhë dymbëdhjetë mujore pas hyrjes së saj

në fuqi, numri i Palëve Kontraktuese është më i vogël se pesë.

Neni 10

1. Çdo vend, në kohën e nënshkrimit të kësaj Konvente, pa rezervën e ratifikimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit, ose në çdo periudhë të mëvonshme, mund të deklarojë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara se kjo Konventë do të jetë e zbatueshme tek të gjitha ose çdo territor për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit ai është përgjegjës. Kjo Konventë do të jetë e zbatueshme në territorin ose territoret e përmendura në njoftim nëntëdhjetë ditë nga data kur Sekretari i Përgjithshëm merr njoftimin, ose, nëse atë ditë kjo Konventë nuk ka hyrë ende në fuqi, nga data e hyrjes së saj në fuqi.

2. Çdo vend që ka bërë një deklaratë sipas paragrafit të mësipërm, që e shtrin zbatueshmërinë e kësaj Konvente në çdo territor për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës, mund ta denoncojë këtë Konventë veçmas për atë territor, në përputhje me dispozitat e nenit 8.

Neni 11

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë Palëve Kontraktuese, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, për sa të jetë e mundur, duhet të zgjidhet me anë të negociatave midis tyre.

2. Çdo mosmarrëveshje që nuk zgjidhet me anë të negociatave, duhet të dërgohet për arbitrazh, nëse një nga Palët Kontraktuese në konflikt e kërkon këtë, dhe do t'i paraqitet me radhë një ose më shumë gjyqtarëve arbitrazhi, të zgjedhur në marrëveshje nga palët në konflikt. Nëse, brenda tre muajve nga data e kërkesës për arbitrazh, palët në konflikt nuk bien dakord për zgjedhjen e gjyqtarit të arbitrazhit ose gjyqtarëve të arbitrazhit, një nga këto Palë Kontraktuese mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të emërojë një gjyqtar të vetëm arbitrazhi, të cilit do t'i paraqitet çështja për vendim.

3. Vendimi i gjyqtarit ose gjyqtarëve të arbitrazhit, të caktuar sipas paragrafit të mësipërm, do të zbatohet nga Palët Kontraktuese në konflikt.

Neni 12

1. Çdo vend, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit në këtë Konventë, mund të deklarojë që nuk e konsideron veten të detyruar prej paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 11 të kësaj Konvente. Palët e tjera Kontraktuese nuk do të jenë të detyruara ndaj këtyre paragrafëve, në lidhje me çdo Palë Kontraktuese, e cila ka një rezervë të tillë.

2. Çdo Palë Kontraktuese, e cila ka paraqitur rezervë siç parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, mundet të tërheqë këtë rezervë në çdo moment duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm.

3. Përveç rezervës së parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, nuk do të lejohet asnjë rezervë tjetër.

Neni 13

1. Tre vjet pasi kjo Konventë ka qëndruar në fuqi, çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë mbledhjen e një Konferencë me qëllim rishikimin e Konventës, duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese që kanë bërë kërkesën dhe një konferencë rishikimi do të mbledhet nga Sekretari i Përgjithshëm nëse, brenda një periudhe katër mujore pas datës së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm, jo më pak se një e treta e Palëve Kontraktuese e njoftojnë atë për miratimin e kërkesës nga ana e tyre.

2. Nëse një konferencë mbledhet në përputhje me paragrafin e mësipërm, Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese dhe t'i ftojë ato të paraqesin brenda një periudhe tre mujore, ato propozime që ato do të dëshironin që Konferenca t'i merrte në shqyrtim. Sekretari i Përgjithshëm duhet të qarkullojë tek të gjitha Palët Kontraktuese një rend të përkohshëm dite të Konferencës, së bashku me tekstet e këtyre propozimeve, të paktën tre muaj para datës në të cilën do të mbledhet Konferenca.

3. Sekretari i Përgjithshëm do të ftojë në çdo konferencë të mbledhur në përputhje me këtë nen të gjitha vendet e paraqitura në nenin 6, paragrafi 1, të kësaj Konvente dhe vendet që janë bërë Palë Kontraktuese sipas nenit 6, paragrafi 2.

Neni 14

1. Çdo Palë Kontraktuese mund të propozojë një ose më shumë amendamente për këtë Konventë. Teksti i çdo amendamenti të propozuar do t'i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do t'ia komunikojë atë të gjithë Palëve Kontraktuese dhe do të informojë të gjitha vendet e tjera të paraqitura në nenin 6, paragrafi 1, të kësaj Konvente.

2. Brenda periudhës prej gjashtë muajsh, nga data kur amendamenti i propozuar është komunikuar nga Sekretari i Përgjithshëm, çdo Palë Kontraktuese mund ta njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm që:

a) ajo ka një kundërshtim për amendamentin e propozuar; ose

b) edhe nëse ka si qëllim të pranojë propozimin, kushtet e nevojshme për këtë pranim nuk janë përmbushur ende në vendin e tij.

3. Nëse një Palë Kontraktuese i dërgon Sekretarit të Përgjithshëm një komunikatë si ajo e përcaktuar në paragrafin 2 (b), përsa kohë që nuk ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e amendamentit të propozuar nga ana e saj, ajo mund të paraqesë një kundërshtim për amendamentin e propozuar brenda një periudhe nëntë mujore, pas skadimit të periudhës gjashtë mujore që nga komunikimi fillestar.

4. Nëse një kundërshtim ndaj amendamentit të propozuar është paraqitur në përputhje me kushtet e paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, amendamenti do të gjykohet i pranuar dhe nuk do të ketë fuqi ligjore.

5. Nëse nuk është shprehur ndonjë kundërshtim ndaj amendamentit të propozuar në përputhje me paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, amendamenti do të gjykohet i pranuar, që nga data e rënë dakord si në vijim:

a) nëse asnjë Palë Kontraktuese nuk i ka dërguar një komunikatë Sekretarit të Përgjithshëm, në përputhje me paragrafin 2 (b) të këtij neni, në ditën e skadimit të periudhës gjashtë mujore të përcaktuar në atë paragraf;

b) nëse asnjë Palë Kontraktuese nuk i ka dërguar një komunikatë Sekretarit të Përgjithshëm, në përputhje me paragrafin 2 (b) të këtij neni, më përpara se dy datat e mëposhtme:

- data kur të gjitha Palët Kontraktuese që dërgojnë komunikata të tilla, kanë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e propozimit nga ana e tyre, me kusht që, nëse të gjitha pranimet janë njoftuar para skadimit të periudhës gjashtë mujore të përcaktuar në paragrafin 2, datë e cila do të konsiderohet të jetë data e skadimit të periudhës gjashtë mujore të përmendur;

- data e skadimit të periudhës nëntë mujore të referuar në paragrafin 3 të këtij neni.

6. Çdo amendament i gjykuar për tu pranuar do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas datës, në të cilën u gjykua për tu pranuar.

7. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese sa më shpejt të jetë e mundur, nëse është paraqitur një kundërshtim ndaj amendamentit të propozuar në përputhje me paragrafin 2 (a) të këtij neni dhe nëse një ose më shumë Palë Kontraktuese i kanë dërguar atij një komunikatë në përputhje me paragrafin 2 (b) të këtij neni. Nëse një ose më shumë Palë Kontraktuese i kanë dërguar atij një komunikatë të tillë, ai duhet të informojë të gjitha Palët Kontraktuese nëse Pala ose Palët Kontraktuese, të cilat i kanë dërguar një komunikatë të tillë, parashtrojnë një kundërshtim ndaj amendamentit të propozuar ose e pranojnë atë.

Neni 15

Përveç njoftimeve të parashikuara në nenet 13 dhe 14 të kësaj Konvente, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të njoftojë vendet e paraqitura në nenin 6, paragrafi 1 të kësaj Konvente dhe vendet, të cilat janë bërë Palë Kontraktuese sipas nenit 6, paragrafi 2, të kësaj Konvente, për:

a) nënshkrimet, ratifikimet dhe aderimet, sipas nenit 6;

b) datat e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 7;

- c) denoncimet sipas nenit 8;
- d) shfuqizimin e kësaj Konvente, në përputhje me nenin 9;
- e) njoftimet e mara, në përputhje me nenin 10
- f) deklaratat dhe njoftimet e mara, në përputhje me nenin 12, paragrafi 1 dhe 2;
- g) hyrjen në fuqi të çdo amendamenti, në përputhje me nenin 14.

Neni 16

Pas 15 marsit 1961, origjinali i kësaj Konvente do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do të transmetojë kopje origjinale tek secili prej vendeve të përmendura në nenin 6, paragrafi 1 dhe 2 të kësaj Konvente.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit, duke qenë plotësisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Gjenevë, më nëntë dhjetor njëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë, në një kopje të vetme në anglisht dhe frëngjisht; të dy tekstet njëlloj autentike.

LIGJ

Nr.9926, datë 9.6.2008

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN “PËR TAKSIMIN E AUTOMJETEVE RRUGORE PËR PËRDORIM PRIVAT NË TRAFIKUN NDËRKOMBËTAR” DHE NË PROTOKOLLIN E NËNSHKRIMIT

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën “Për taksimin e automjeteve rrugore për përdorim privat në trafikun ndërkombëtar” dhe në protokollin e nënshkrimit, nënshkruar në Gjenevë më 18 maj 1956.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5782, datë 30.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

KONVENTA
MBI TAKSIMIN E AUTOMJETEVE RRUGORE PËR PËRDORIM PRIVAT NË TRAFIKUN
NDËRKOMBËTAR DHE PROTOKOLLI I NËNSHKRIMIT
Bërë në Gjenevë më 18 maj 1956

Palët Kontraktuese,
duke marrë në konsideratë se disa Shtete Evropiane kanë arritur marrëveshje dypalëshe, ose kanë ndërmarrë hapa të tjerë për caktimin e një procedure më liberale sesa ajo e Konventës së 30 marsit 1931 mbi taksimin e mjeteve motorike të huaja;
me dëshirën për të lehtësuar zhvillimin e turizmit ndërkombëtar,
kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Për qëllime të kësaj Konvente:

a) Termi “automjete” nënkupton të gjithë biçikletat, automjetet vetëlëvizëse dhe të gjithë rimorkiot të lidhur me këto automjete, qoftë të importuar së bashku me automjetin, qoftë veçmas, me përjashtim, gjithsesi, të automjeteve ose kombinimeve të lidhura me to për transportin e udhëtarëve, të cilët kanë më shumë se tetë vende, përveç vendit të shoferit.

b) Termi “përdorim privat” do të përjashtojë transportin e udhëtarëve kundrejt pagesës, shpërblimit ose formave të tjera dhe transportin për nevoja industriale ose tregtare të mallrave me ose pa pagesë.

Neni 2

Automjetet e regjistruara në territorin e njërit prej Shteteve Kontraktues, automjetet e lejuara për të qarkulluar në këtë vend, si edhe ato të përjashtuara nga detyrimi për tu regjistruar në këtë territor, kur qëndrojnë përkohësisht për përdorim privat në territorin e një Shteti tjetër Kontraktues, do të përjashtohen nga taksat dhe pagesat tarifore të vëna për qarkullimin ose mbajtjen e automjeteve në territorin e atij Shteti Kontraktues, sipas kushteve të përcaktuara më poshtë. Ky përjashtim nuk duhet të zbatohet për pagesat, taksat dhe detyrimet për përdorim.

Neni 3

1. Për automjetet e përmendura në nenin 2, ky përjashtim do të bëhet në territorin e një Shteti Kontraktues, përsa kohë të përmbushen kushtet e përcaktuara në Rregulloren Doganore në fuqi të atij territori për pranim të përkohshëm pa pagesë, pa detyrime të importit dhe taksa të importit.

2. Megjithatë, një Shtet Kontraktues mund të kufizojë kohëzgjatjen e këtij përjashtimi në treqind e gjashtëdhjetë e pesë ditë, edhe në qoftë se automjeti pranohet përkohësisht pa pagesën e detyrimeve të importit dhe taksave të importit për një periudhë më të gjatë.

Neni 4

Kur një Shtet Kontraktues i Konventës së 30 marsit 1931 “Mbi taksimin e automjeteve të huaja”, bëhet Palë Kontraktuese e kësaj Konvente, ai duhet të marrë menjëherë masat e përcaktuara në nenin 17 të Konventës së vitit 1931, për ta denoncuar këtë Konventë.

Dispozita përfundimtare

Neni 5

1. Vendet që janë anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën dhe vendet e pranura në

Komision si palë konsultative, sipas paragrafit 8 të termave të referencës të Komisionit, mund të bëhen Palë Kontraktuese të kësaj Konvente:

- a) duke e nënshkruar atë;
- b) duke e ratifikuar pas nënshkrimit me qëllim ratifikimi;
- c) duke e pranuar.

2. Vendet që marrin pjesë në veprimtari të caktuara të Komisionit Ekonomik për Europën, sipas paragrafit 11 të termave të referencës së Komisionit, mund të bëhen Palë Kontraktuese e kësaj Konvente, duke e pranuar atë pas hyrjes së saj në fuqi.

3. Konventa do të jetë e hapur për nënshkrim deri më 31 gusht 1956. Në periudhën në vazhdim, ajo do të jetë e hapur për pranim.

4. Ratifikimi ose pranimi, do të bëhet efektiv pas depozitimit të një instrumenti pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 6

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë nga data kur të pesë shtetet e përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1, e kanë nënshkruar ratifikimin pa rezerva ose kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet tjetër që e ratifikon apo e pranon, pasi pesë shtetet e kanë nënshkruar atë pa rezerva, ose kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose aderimit, kjo Konventë do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë nga data kur vendi i përmendur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 7

1. Çdo Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Konventë duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi do të hyjë në fuqi pesëmbëdhjetë muaj nga data kur Sekretari i Përgjithshëm merr njoftimin për denoncimin.

Neni 8

Kjo Konventë nuk do të jetë më në fuqi në rast se për një periudhë 12 mujore pasi ka hyrë në fuqi, numri i Palëve Kontraktuese është më pak se pesë.

Neni 9

1. Në kohën e nënshkrimit të kësaj Konvente pa rezerva për ratifikimin ose depozitimin e një instrumenti ratifikimi ose aderimi, apo në çdo kohë pas kësaj, çdo shtet mund të deklarojë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, nëse kjo Konventë do të mbulojë të gjitha, ose ndonjë nga fushat e marrëdhënieve ndërkombëtare, për të cilat është përgjegjëse. Konventa do të mbulojë hapësirën ose hapësirat e përmendura në njoftim, që nga dita e nëntëdhjetë pasi Sekretari i Përgjithshëm ka marrë dijeni, ose, në rast se atë ditë Konventa nuk ka hyrë ende në fuqi, në kohën kur ajo hyn në fuqi.

2. Çdo shtet, që ka bërë deklaratën sipas paragrafit të mësipërm, për ta shtrirë këtë Konventë në atë hapësirë të marrëdhënieve ndërkombëtare për cilën ajo është përgjegjëse, mund ta denoncojë Konventën për sa i përket kësaj hapësire, në përputhje me dispozitat e nenit 7.

Neni 10

1. Çdo mosmarrëveshje midis dy ose më shumë Palëve Kontraktuese në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente duhet të zgjidhet brenda mundësive me negociata ndërmjet tyre.

2. Çdo mosmarrëveshje, e cila nuk zgjidhet me anë të negociatave, duhet të dorëzohet për

arbitrazh, në rast se një nga Palët Kontraktuese në konflikt e kërkon këtë, dhe do t'i referohet me radhë një ose më shumë gjyqtarëve të arbitrazhit të zgjedhur në marrëveshje nga Palët në konflikt. Në rast se brenda tre muajve nga data e kërkesës për arbitrazh, Palët në konflikt nuk bien dakord mbi zgjedhjen e një gjyqtari arbitrazhi ose gjyqtarëve të arbitrazhit, një nga Palët mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të emërojë një gjyqtar të vetëm arbitrazhi, të cilit duhet t'i jepet çështja për vendim.

3. Vendimi i gjyqtarit ose gjyqtarëve të arbitrazhit, të emëruar sipas paragrafit të mësipërm, do të jetë detyrues për palët në konflikt.

Neni 11

1. Çdo Palë Kontraktuese, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, ose pranimi në këtë Konventë, ose në çdo kohë të mëvonshme, mund të deklarojë që nuk do ta zbatojë Konventën për automjetet pa motorë.

2. Çdo Palë Kontraktuese, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, apo pranimi në këtë Konventë, mund të deklarojë që nuk e konsideron veten të detyruar nga neni 10 i Konventës. Palët e tjera Kontraktuese nuk do të jenë të detyruara nga neni 10, në lidhje me Palën Kontraktuese që ka regjistruar një rezervë ndaj ratifikimit.

3. Çdo Palë Kontraktuese që ka regjistruar një rezervë, si ajo e përmendur në paragrafin 1 ose paragrafin 2, mund ta tërheqë rezervën duke lajmëruar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

4. Nuk lejohet asnjë rezervë tjetër për këtë Konventë.

Neni 12

1. Tre vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente, çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë mbledhjen e një Konference me qëllim rishikimin e Konventës, duke lajmëruar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese për kërkesën dhe një Konferencë rishikimi do të mbledhet nga Sekretari i Përgjithshëm në rast se, brenda një periudhe katër mujore nga data e njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm, jo më pak se një e treta e Palëve Kontraktuese e njoftojnë atë për pajtimin e tyre me kërkesën.

2. Në rast se konferenca mbledhet në përputhje me paragrafin e mësipërm, Sekretari i Përgjithshëm duhet të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese dhe t'i ftojë ato të paraqesin brenda një periudhe tre mujore, propozimet që ato dëshirojnë që Konferenca t'i marrë në konsideratë. Sekretari i Përgjithshëm duhet të qarkullojë te të gjitha Palët Kontraktuese rendin provizor të ditës për Konferencën, së bashku me tekstet e propozimeve, të paktën tre muaj para datës në të cilën do të zhvillohet Konferenca.

3. Në çdo Konferencë të mbledhur në përputhje me këtë nen, Sekretari i Përgjithshëm duhet të ftojë të gjitha shtetet e përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1, dhe vendet që janë bërë Palë Kontraktuese sipas nenit 5, paragrafi 2.

Neni 13

1. Çdo Palë Kontraktuese mund të propozojë një ose më shumë amendamente për këtë Konventë. Teksti i çdo amendamenti të propozuar duhet të transmetohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili e transmeton këtë te të gjitha Palët Kontraktuese dhe informon të gjitha shtetet e tjera të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1.

2. Çdo amendament i propozuar, i qarkulluar sipas paragrafit të mësipërm do të vlerësohet i pranuar, në rast se asnjë nga Palët Kontraktuese nuk shpreh ndonjë kundërshtim brenda një periudhe gjashtë mujore që nga data e qarkullimit të amendamentit të propozuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Sekretari i Përgjithshëm duhet të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese sa më parë që të jetë e mundur, në rast se është shprehur ndonjë kundërshtim për amendamentin e propozuar. Në rastin kur

është shprehur një kundërshtim për amendamentin e propozuar, amendamenti do të vlerësohet i papranuar dhe nuk do të ketë asnjë efekt. Në rast se nuk është shprehur asnjë kundërshtim i tillë, amendamenti do të hyjë në fuqi për të gjitha Palët Kontraktuese tre muaj pas përfundimit të periudhës gjashtë mujore të përcaktuar në paragrafin e mësipërm.

Neni 14

Përveç njoftimeve të parashikuara nga nenet 12 dhe 13, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara duhet të njoftojë shtetet e përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1 dhe shtetet që janë bërë Palë Kontraktuese sipas nenit 5, paragrafi 2, për:

- a) nënshkrimet, ratifikimet, ose aderimet sipas nenit 5;
- b) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 6;
- c) denoncimet sipas nenit 7;

- d) rënien nga fuqia të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 8;
- e) njoftimet e marra, në përputhje me nenin 9;
- f) deklaratat dhe njoftimet e marra, në përputhje me nenin 11, paragrafi 1 dhe 2;
- g) hyrjen në fuqi të çdo amendamenti, në përputhje me nenin 13.

Neni 15

Protokolli i nënshkrimit të kësaj Konvente do të ketë të njëjtin fuqi, efekt dhe kohëzgjatje, si vetë Konventa, te e cila është pjesë përbërëse.

Neni 16

Pas datës 31 gusht 1956, origjinali i kësaj Konvente do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do të transmetojë kopje origjinale të certifikuara të çdo vend i përmendur në nenin 5, paragrafi 1 dhe 2.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit, duke qenë plotësisht të autorizuar, kam nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Gjenevë, më tetëmbëdhjetë maj, njëmijë e nëntë qind e pesëdhjetë e gjashtë, në një kopje të vetme në anglisht dhe frëngjisht, secili tekst njëlloj autentik.

PROTOKOLLI I NËNSHKRIMIT

Gjatë procedurave të sotme të nënshkrimit të Konventës mbi Taksimin e Automjeteve Rugore për Përdorim Privat në Trafikun Ndërkombëtar, të nënshkruarit, duke qenë plotësisht të autorizuar, kanë rënë dakord për kushtet dhe kanë mbajtur shënimet përkatëse për rezervat e mëposhtme:

1. Për qëllime të kësaj Konvente, përdorimi i një automjeti të marrë me qira do të konsiderohet si përdorim privat i automjetit, në qoftë se automjeti merret me qira pa shofer, si dhe në rast se personi që e merr automjetin me qira merr shofer.

2. Transporti i bagazheve personale që i përkasin udhëtarëve, ose në rastin e përfaqësuesve tregtarë, transporti i mostrave, nuk duhet të ndalojë përdorimin e automjetit nga qëllimi për përdorim privat.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit, duke qenë plotësisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Gjenevë, më tetëmbëdhjetë maj njëmijë e nëntë qind e pesëdhjetë e gjashtë, në një kopje të vetme në anglisht dhe frëngjisht; secili tekst njëlloj autentik.

LIGJ
Nr.9927, datë 9.6.2008

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 3, DATË 28.5.2008
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DËRGIMIN NË REPUBLIKËN E ÇADIT DHE NË
REPUBLIKËN E AFRIKËS QENDRORE, SI KONTRIBUT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, TË NJË KOMPANIE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, PËR TË MARRË
PJESË NË OPERACIONIN “EUFOR TCHAD/RCA” TË BASHKIMIT EUROPIAN”**

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.3, datë 28.5.2008, i Këshillit të Ministrave “Për dërgimin në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore, si kontribut i Republikës së Shqipërisë, të një kompanie të Forcave të Armatosura, për të marrë pjesë në operacionin “EUFOR TCHAD/RCA” të Bashkimit Europian”.

**Shpallur me dekretin nr.5783, datë 30.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

AKTNORMATIV
Nr. 3, datë 28.5.2008

**PËR DËRGIMIN NË REPUBLIKËN E ÇADIT DHE NË REPUBLIKËN E AFRIKËS
QENDRORE, SI KONTRIBUT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË NJË KOMPANIE TË
FORCAVE TË ARMATOSURA, PËR TË MARRË PJESË NË OPERACIONIN “EUFOR
TCHAD/RCA”, TË BASHKIMIT EUROPIAN**

Në mbështetje të neneve 12 pika 3 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Dërgimin në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore, të një kompanie të Forcave të Armatosura, në kuadër të kontributit të Republikës së Shqipërisë, në operacionin “EUFOR

Tchad/RCA”, të Bashkimit European, në zbatim të rezolutës nr. 1778, datë 25.9.2007, të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 2

Misioni i autorizuar i kompanisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë të jetë, si më poshtë vijon:

1. Sigurimi i Shtabit të Përgjithshëm të EUFOR-it, me vendndodhje në qytetin e N’Dajmenës, Republika e Çadit.
2. Patrullimi në rajonin e qytetit të N’Dajmenës.
3. Shoqërimi dhe sigurimi i personaliteteve civile dhe ushtarake, të rëndësishme, nga aeroporti në kamp, e anasjelltas.
4. Shoqërimi dhe sigurimi i trupave, që mund të lëvizin nga kampi, që ndodhet në qytetin N’Dajmena, për kampin, që ndodhet në qytetin Abéché, përfshirë edhe sigurimin e këtyre trupave, sipas situatës operationale.

Neni 3

Ushtarakët, që do të marrin pjesë në operacionin “EUFOR Tchad/RCA”, për ditët e qëndrimit në këtë operacion, veç pagës mujore marrin, për vështirësi shërbimi, edhe një shpërblim ditor, në masën, që do të caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Shpenzimet për pjesëmarrjen në operacionin “EUFOR Tchad/RCA”, të kompanisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, mbështetur edhe në marrëveshjet ndërkombëtare, të lidhura për këtë qëllim.

Neni 5

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIGJ Nr.9928, datë 9.6.2008

PËR SHËRBIMIN SHËNDETËSOR STOMATOLOGJIK NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Ky ligj përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e shërbimit shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë.

2. Ky ligj zbatohet nga/ndaj personat/personave fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën e shërbimit shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Financimi i shërbimit shëndetësor stomatologjik publik

1. Në institucionet e shërbimit shëndetësor stomatologjik publik ofrohet falas shërbimi profilaktik dhe mjekues stomatologjik për:

- a) personat nga mosha 0 deri 18 vjeç;
- b) të sëmurët e shtruar dhe ata që trajtohen në institucione spitalore publike, për mjekime urgjence;
- c) kategori të veçanta individësh që, me ligje dhe akte nënligjore të veçanta, përfitojnë shërbim shëndetësor stomatologjik falas.

2. Shteti merr përsipër të mbulojë pjesërisht:

- a) shërbimin e urgjencave stomatologjike për moshat mbi 18 vjeç;
- b) shërbime stomatologjike në Departamentin e Stomatologjisë në Fakultetin e Mjekësisë;
- c) shërbime stomatologjike në institucionet stomatologjike publike.

3. Masa dhe mënyra e kontributit të shtetit për shërbimet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Shërbimi i urgjencës stomatologjike

1. Shërbimi i urgjencës stomatologjike ofrohet në:

- a) institucionet publike shëndetësore spitalore;
- b) institucionet publike shëndetësore stomatologjike ambulatorë.

2. Në ato institucione shëndetësore, ku nuk mund të ofrohet shërbimi i urgjencës, sipas pikës 1 të këtij neni, lidhen kontrata shërbimi me subjekte, që ofrojnë shërbim stomatologjik privat.

Neni 4

Shërbimi shëndetësor stomatologjik në institucionet arsimore

1. Shërbimi profilaktik, diagnostikues dhe edukimi shëndetësor stomatologjik ofrohen në të gjitha institucionet arsimore të nivelit të detyrueshëm.

2. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës nxjerrin udhëzimin e përbashkët për funksionimin dhe organizimin e këtij shërbimi në këto institucione arsimore.

KREU II

INSTITUCIONET SHËNDETËSORE STOMATOLOGJIKE, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I TYRE

Neni 5

Institucionet që ofrojnë shërbim shëndetësor stomatologjik

1. Shërbimi shëndetësor stomatologjik ofrohet nga:

- a) institucionet shëndetësore stomatologjike publike;
- b) institucionet shëndetësore stomatologjike private.

2. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të institucioneve shëndetësore stomatologjike përcaktohet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

Neni 6

Licencimi

1. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, ushtrojnë veprimtarinë në shërbimin shëndetësor stomatologjik vetëm pas licencimit pranë Ministrisë së Shëndetësisë ose autoriteteve të autorizuar prej saj.
2. Procedurat dhe kriteret e licencimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Personeli i shërbimit shëndetësor stomatologjik

1. Shërbimi shëndetësor stomatologjik ofrohet nga personeli:
 - a) mjek stomatolog;
 - b) ndihmësmjek stomatolog;
 - c) laborant dentar.
2. Personeli i shërbimit shëndetësor stomatologjik e ushtron veprimtarinë në përputhje me rregullat e miratuara nga Ministri i Shëndetësisë.

KREU III

MBIKËQYRJA NË SHËRBIMIN SHËNDETËSOR STOMATOLOGJIK

Neni 8

Inspektorati Shëndetësor Stomatologjik

1. Mbiqëqyrja në shërbimin shëndetësor stomatologjik kryhet nga Inspektorati Shëndetësor Stomatologjik.
2. Inspektorati Shëndetësor Stomatologjik organizohet dhe funksionon në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.
3. Inspektorati Shëndetësor Stomatologjik është organi ekzekutiv i specializuar për kontrollin e zbatimit të këtij ligji dhe të akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.
4. Struktura dhe organika e Inspektoratit Shëndetësor Stomatologjik miratohen nga Kryeministri, me propozim të Ministrit të Shëndetësisë.
5. Rregullat e funksionimit të Inspektoratit Shëndetësor Stomatologjik miratohen nga Ministri i Shëndetësisë.

KREU IV

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 9

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen:
 - a) shkelja e nenit 6, me gjobë 50 000 lekë dhe me ndërprerje të veprimtarisë deri në plotësimin e dokumentacionit, sipas legjislacionit në fuqi;
 - b) shkelja e rregullave të përmendura në pikën 2 të nenit 7 të këtij ligji, me gjobë deri në 50 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje, me mbyllje të veprimtarisë.
2. Autoriteti përgjegjës për vënien dhe ekzekutimin e gjobave është Inspektorati Shëndetësor Stomatologjik.

Neni 10

Ankimi

Procedurat për vënien e gjobave për kundërvajtjet administrative dhe ankimi për to bëhen në përputhje me ligjin nr.7679, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, të ndryshuar.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 11
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 2 pika 3 dhe 6 pika 2 të këtij ligji.
2. Ngarkohet Ministri i Shëndetësisë të nxjerrë urdhrat në zbatim të neneve 5 pika 2, 7 pika 2 dhe 8 pika 5 të këtij ligji.
3. Ngarkohet Ministria Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës të nxjerrin udhëzimin e përbashkët në zbatim të nenit 4 pika 2 të këtij ligji.

Neni 12
Shfuqizime

Ligji nr.8167, datë 21.11.1996 “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik”, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.5784, datë 30.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr.9929, datë 9.6.2008

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8950, DATË 10.10.2002 “PËR GJENDJEN CIVILE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 34 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 34
Deklarimi i lindjes

1. Lindja e fëmijës deklarohet te nëpunësi i gjendjes civile nga prindërit, pjesëtarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarë dhe, në pamundësi ose në mungesë të tyre, nga personat që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen. Deklarimi mund të bëhet edhe nga përfaqësues të nënës, me prokurë të posaçme.

2. Deklarimi i lindjes së fëmijës së gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, bëhet nga organet e njësisë së qeverisjes vendore, organi i rendit publik, në juridiksionin e të cilit ndodhet vendi i gjetjes, në bazë të procesverbalit të mbajtur në kohën e gjetjes së fëmijës.”.

Neni 2

Pas nenit 34 shtohet neni 34/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 34/1 Regjistrimi i lindjes

1. Regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të prindërve.
2. Për fëmijën e gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, regjistrimi bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendit ku është gjetur.
3. Për fëmijën e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas shqiptarë, me banim të përhershëm në Shqipëri, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në përfaqësitë diplomatike ose konsullore shqiptare në vendin ku ka lindur. Kur kjo është e pamundur, regjistrimi bëhet edhe në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi.
4. Kur regjistrimi i lindjeve deklarohet brenda 60 ditëve, për lindjen brenda vendit dhe 90 ditëve, për lindjen jashtë vendit, nëna përfiton shpërblim në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.
5. Për të gjitha lindjet e padeklaruara deri tani dhe që kanë kaluar afatin, nëna do të përfitojë shpërblim në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, nëse bën deklarinin brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
6. Fondi për shpërblim për pikat 4 dhe 5 të këtij neni përballohet nga Buxheti i Shtetit dhe tërhiqet pranë njësive të qeverisjes vendore përkatëse.
7. Të gjitha subjektet shëndetësore, shtetërore dhe private, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruara që çdo ditë të hënë të dërgojnë në zyrat e gjendjes civile, ku prindërit kanë vendbanimin, njoftimin për lindjet e ndodhura pranë institucioneve të tyre.
8. Njësitë operative të policisë në terren, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, konstatojnë dhe konfirmojnë, në rrugë zyrtare, rastet e lindjeve dhe regjistrimin e tyre nga personat e parashikuar në nenin 34 pika 2, në zonën që ata mbulojnë.”.

Neni 3

Në nenin 69 pika 1, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) shkelja ose moszbatimi i dispozitës së parashikuar në pikën 6 të nenit 34/1 dënohet me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5785, datë 30.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

**LIGJ
Nr.9930, datë 9.6.2008**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9734, DATË 14.5.2007 “PËR
TURIZMIN”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 5 e 8 shfuqizohen.

2. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

“12. “Njësi akomoduese” është struktura, në pronësi apo përdorim të personave fizikë ose juridikë, të cilët vënë në dispozicion të klientëve vendas dhe të huaj, individë apo të organizuar në grupe, shërbimet e fjetjes, të ushqimit, pijes, si dhe lehtësitë e duhura, në objekte komode, kushte të mira pritjeje, nga një staf i kualifikuar, për një kohë qëndrimi të papërcaktuar.

Në një njësi akomoduese përfshihen:

a) “Hotel”, një ndërtesë ose një grup ndërtesash, të pavarura nga ndonjë vendndodhje ndërtimi tjetër, me jo më pak se 6 dhoma, brenda një parcele të vetme toke, ku akomodimi, shërbimet shtesë dhe komoditeti ofrohen për publikun nga një staf i kualifikuar.

b) “Fshat turistik”, struktura komplekse akomoduese, ku ndërtesat nuk e kalojnë lartësinë e tri kateve, me vendndodhje në zona turistike, brenda një parcele të vetme toke dhe të përcaktuar, që ofron, në mënyrë të përqendruar, gamën më të plotë të shërbimeve akomoduese turistike, shërbimet e veprimtarive sportive, argëtuese dhe çlodhëse, nga një staf i kualifikuar.

c) “Kompleks turistik”, një kompleks ndërtesash, të grupuara, si apartamente, vila, studio, ndërtesa të vogla me dy kate, që ofron për klientët akomodim, cilësi, shërbime ndihmëse, vetëshërbim, nga një staf i kualifikuar.

ç) “Shtëpi pushimi”, ka të njëjtin kuptim si hoteli, në lidhje me vendndodhjen, por, në terma më specifikë, janë ndërtesa ose një pjesë ndërtese me hyrje të veçantë, që menaxhohen dhe operohen nga një staf i kualifikuar dhe që ofron për klientët standardet bazë të akomodimit, shërbimeve ndihmëse dhe cilësisë. Dhoma mund të ndahet nga klientët.

d) “Bujtinë”, ka të njëjtin kuptim si hoteli, në lidhje me vendndodhjen, por, në terma më specifikë, janë ndërtesa ose një pjesë ndërtese me hyrje të veçantë, që menaxhohet dhe operohet nga një staf i kualifikuar, me dhoma me komoditet, për përdorim nga klientët, me ndryshimin se elementet sanitare janë parashikuar të jenë në raporte të tilla: së paku një tualet dhe dush për çdo dhjetë persona ose një tualet dhe dush për një kat.”.

3. Pika 20 ndryshohet si më poshtë:

“20. “Paketë turistike” është një kombinim i parapërgatitur shërbimesh, që shitet ose ofrohet për shitje dhe mbulon një periudhë për më shumë se 24 orë ose përfshin një natë akomodim. Ajo përbëhet nga jo më pak se dy prej shërbimeve të mëposhtme:

- transport;

- akomodim;

- shërbime të tjera turistike, të pavarura nga transporti dhe akomodimi dhe që përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të paketës, që do të përfshihen në këtë kombinim të parapërgatitur dhe kur këta komponentë janë faturuar si zëra të veçantë.”.

4. Pika 22 ndryshohet si më poshtë:

“22. “Restorant” është një sipërmarrje e furnizimit me ushqimin e lejueshëm për publikun, ku qëllimi kryesor është shitja e ushqimit për konsum, jashtë ose brenda lokalit (mjedisi), me shërbim në tryezë ose banak, në përputhje me standarde të përcaktuara.”.

5. Pika 24 ndryshohet si më poshtë:

“24. “Sipërmarrje turistike” është veprimtaria turistike, që ushtrohet nga persona fizikë apo juridikë, të tilla si: hotel, fshat turistik, kompleks turistik, njësi të tjera akomoduese, agjenci udhëtimi, operator turistik, agjenci në terren, transport të turistëve, prodhim ose shitje me pakicë të suvenireve

apo punimeve artizanale, pika të tërheqjes së vizitorëve, sporte ujore ose ndonjë biznes tjetër.”.

6. Në pikën 37, fjalia e fundit shfuqizohet.

7. Pika 40 ndryshohet si më poshtë:

“40. “Kërkesë për zhvillimin e një sipërmarrjeje turistike” është kërkesa që bëhet përpara autoritetit të planifikimit, për të marrë leje zhvillimi për një ndërtim të ri apo ndryshim të rëndësishëm, si hotel, fshat turistik, kompleks turistik dhe njësi të tjera akomoduese.”.

Neni 2

Në nenin 11, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Komisioni i Standardeve të Turizmit, në vazhdim KST, është struktura që shqyrton kërkesat për zhvillimin e sipërmarrjeve turistike dhe ia paraqet për miratim ministrit përgjegjës për turizmin.”.

Neni 3

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

Përcaktimi i zonave të zhvillimit të turizmit

1. Përcaktimi i zonave të zhvillimit të turizmit bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Zhvillimi i zonave, vendeve dhe pikave turistike bëhet në bazë të masterplanit kombëtar të zhvillimit të turizmit, të regjistrit të burimeve turistike dhe planifikimit të zhvillimit ekonomik-social të tyre.”.

Neni 4

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 21

Procedura për përcaktimin e zhvillimit të sipërmarrjeve turistike dhe lehtësitë e përfitimit të asistencës financiare

1. Kërkesa për zhvillimin e një sipërmarrjeje turistike, si hotel, fshat turistik, kompleks turistik dhe njësi akomoduese, pas miratimit nga organet e qeverisjes vendore dhe përpara se të merret miratimi përfundimtar nga organi kompetent, sipas dispozitave ligjore në fuqi, duhet të marrë miratimin e ministrit përgjegjës për turizmin, në përputhje me kriteret e vendosura për këtë qëllim.

2. Kriteret dhe procedurat për zhvillimin e sipërmarrjeve turistike, si hotel, fshat turistik, kompleks turistik dhe njësi të tjera akomoduese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Përfitimi i lehtësive dhe i asistencës financiare për një sipërmarrje turistike, si hotel, fshat turistik, kompleks turistik dhe njësi të tjera akomoduese, bëhet në përputhje me përcaktimet e nenit 26 të këtij ligji, si dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin e ndihmës shtetërore.”.

Neni 5

Në nenin 25 pika 2, shkronja “a” shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 27, në fund të pikës 2 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Subjekti, të cilit i është ndërprerë asistenca financiare me urdhër të ministrit përgjegjës për

turizmin, është i detyruar të kthejë të gjithë shumën e përfituar, së bashku me interesat.”.

Neni 7

Neni 28 shfuqizohet.

Neni 8

Neni 29 shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 30, pika 2 shfuqizohet.

Neni 10

Pas nenit 30 shtohen nenet 30/1 dhe 30/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 30/1

Ndalimi i shitjes së njësive të veçanta akomoduese

Personat fizikë apo juridikë, që kanë marrë miratimin e ministrit përgjegjës për turizmin për zhvillimin e hoteleve, fshatrave turistikë, komplekseve turistike dhe njësive të tjera akomoduese, në truall publik, sipas ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, nuk lejohen të shesin njësi të veçanta të tyre.

Neni 30/2

Kushtet e transferimit të objektit të veprimtarisë

1. Edhe në rast të transferimit të titullit të objektit të veprimtarisë për zhvillimin dhe administrimin e hoteleve, fshatrave turistikë, komplekseve turistike dhe njësive të tjera akomoduese, në truall publik, sipas dispozitave të Kodit Civil, subjekti përfitues nuk lejohet të ndryshojë destinacionin turistik apo të shesë njësi të veçanta të tyre.

2. Titullari përfitues duhet të plotësojë të njëjtat kritere si transferuesi paraardhës dhe duhet të marrë miratimin përkatës pranë ministrit përgjegjës për turizmin.

3. Në rast se nuk zbatohen neni 30/1 dhe pikat 1 dhe 2 të këtij neni, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nuk bën regjistrimin e pasurisë.”.

Neni 11

Në nenin 32, në fund të pikës 1 fjalët “sipërmarrje turistike” zëvendësohen me fjalët “sipërmarrje të tjera turistike”.

Neni 12

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 36

Shoqëruesi i udhëtimit

Çdo agjent/agjenci udhëtimi apo operator turistik, që ka punësuar një shoqërues udhëtimi, duhet të lidhë kontratë, sipas ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Neni 13

Në nenin 42 pika 2, fjalët “për t’u licencuar si guidë, në përputhje me fushën dhe profilin e duhur dhe lëshon certifikata profesionale” zëvendësohen me fjalët “që ushtrojnë veprimtarinë e guidës turistike”.

Neni 14

Në nenin 45, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Shkeljet e përcaktuara në nenet 30/1 e 30/2 të këtij ligji ndëshkohen me gjobë deri në 100 për qind të vlerës së investimit.”.

Neni 15

Në nenin 48, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Subjektet që kanë lidhur marrëveshje qiraje dhe zhvillimi me ministrinë përgjegjëse për turizmin, sipas ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, të ndryshuar dhe nuk i kanë respektuar kushtet e marrëveshjeve dënohen nga Agjencia Kombëtare e Turizmit me gjobë në masën 100 për qind të detyrimit financiar që rrjedh nga moszbatimi i neneve respektive të marrëveshjes.”.

Neni 16

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4 pika 1 e 5 pika 2 brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5786, datë 30.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ

Nr.9931, datë 9.6.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9632, DATË 30.10.2006 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 17 “Kundërvajtjet dhe sanksionet” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 17

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

Shkeljet e dispozitave për taksën vendore mbi biznesin e vogël, që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënimet përkatëse përcaktohen në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa mosafishimi ose mosparaqitja e certifikatës së regjistrimit dënohet me gjobë 5 000 lekë.”.

Neni 2

Neni 34 “Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 34

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

Shkeljet e dispozitave për taksat e tjera vendore, që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënimet përkatëse përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5787, datë 30.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.9932, datë 9.6.2008

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8977, DATË 12.12.2002 “PËR SISTEMIN E
TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 11 “Kundërvajtjet administrative” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11
Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e dispozitave për taksat kombëtare, që përbëjnë kundërvajtje administrative, përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Neni 12 “Dënimet” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12
Sanksionet

Dënimet administrative për kundërvajtjet në taksat kombëtare përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5788, datë 30.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

**VENDIM
Nr.192, datë 30.6.2008**

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR KODIN
ZGJEDHOR**

Në mbështetje të nenit 77 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

- I. Ngrihet Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Kodin Zgjedhor.
- II. Komisioni ka për detyrë përgatitjen e amendamenteve të nevojshme të kuadrit ligjor për arritjen e standardeve në zgjedhje.
- III. Anëtarësia e Komisionit formohet bazuar në numrin e grupeve parlamentare. Çdo grup parlamentar përfaqësohet me 1 (një) anëtar në Komision.
- IV. Komisioni i Posaçëm Parlamentar drejtohet nga dy bashkëkryetarë, një nga partia Demokratike dhe një nga Partia Socialiste.
- V. Secili anëtar përfaqëson dhe vendos në emër të të gjithë deputetëve që ka në Kuvend grupi që ai përfaqëson. Votat përfaqësuese për secilin anëtar të Komisionit përcaktohen në pikën VII të këtij vendimi.

VI. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme kur anëtarët që marrin pjesë në to përfaqësojnë shumicën e vendeve në Kuvend. Vendimet në Komision merren kur votat “pro” përfaqësojnë shumicën e vendeve në Kuvend, por, në çdo rast, kur pro tyre kanë votuar në unanimitet të dy bashkëkryetarët e Komisionit.

VII. Përbërja e Komisionit dhe votat përfaqësuese janë si më poshtë:

1. Ilir Rusmali	(PD	42 vota)
2. Fatmir Xhafa	(PS	33 vota)
3. Arjan Madhi	(PR	11 vota)
4. Engjëll Bejtaj	(PSD	7 vota)
5. Ndue Shpani	(PDK	8 vota)
6. Spartak Braho	(LSI	7 vota)
7. Petrit Gjoni	(PAA	7 vota)
8. Tritan Shehu	(PDR	7 vota)
9. Spiro Peçi	(PBDNJ	7 vota)

VIII. Pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar ngrihet grupi i ekspertëve teknikë. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të tij përcaktohen me vendim të Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

IX. Komisioni e ushtron veprimtarinë për një afat prej një muaj nga data e mbledhjes së parë të tij.

X. Ngarkohet Kryetarja e Kuvendit për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së Komisionit.

XI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 1.7.2008
Doli nga shtypi më 1.7.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 35 lekë